

maje të së cilës është një formë e vetme e pastër, iniciator i pëlëvizshëm i çdo gjëje që lëviz - Zoti. Logjikën e ka themeluar në mësimin e tri principeve të mendimit të shëndosh; principi i identitetit, i kundërtënes dhe eliminimi i të tretës. Në etikë ka përfaqësuar audajmonizmin racional dhe në te ka themeluar doktrinën mbi virtytin (vlerën) intelektual dhe virtytet e karakterit. Kjo e dyta është përmbajtja rationale e arsyeshmërisë në mes të dy ekstremeve. Emrat e këtyre filozofëve edhe sot e kësaj ditë dëgjoen dhe përmenden. Mendimi shkencor në këtë periudhë greke i ka dhuruar njerëzimit më shumë se cila do periudhë tjetër para kësaj si në lëminë e filozofisë dhe të shkencës, ashtu edhe në teori dhe ligje, të cilat njerëzimi më parë nuk i ka njohur. Kështu njerëzimi u njohua me ligjet e kimisë, me teorinë e elementeve, dhe të numrave, me teorinë atomistike të Demokritit, me teorinë e Hipokratit në mjekësi, me teorinë e Pitagorës në matematikë, me teorinë e Platonit në gjeometri, anatomi, biologji dhe minerologji, duke marrë nga mësuesi i parë, Aristoteli, më shumë se prej cilitdo tjetër. Shkenca greke zotëronte dhe Athina mburrej me Akademinë e Platonit dhe me Likën e Aristotelit. Kultura dhe shkenca greke dominonte edhe në vendet fqinje, të cilët dikur kanë pasur kulturë të zhvilluar, por që s'ka qenë e fortë e të durojë mendimin shkencor të vullshëm grek. Kjo është shkas për shumë historianë që periudhën greke ta marrin si fillim të vërtetë të mendimit shkencor, edhe pse është e qartë se kultura dhe shkenca greke nuk ka mundur papritmas të paraqitet në këtë nivel, duke mos shfrytëzuar kulturat, të cilat kanë paraprirë. Historikisht janë vërtetuar kontaktet dhe lidhjet e shkencëtarëve grek me shkencëtarët egjiptasë në brigjet e Nilit dhe me babilonasit në Mesopotami. Nuk ka dyshim se mendimi shkencor në periudhën greke ka bërë kërcim të madhë dhe i ka dhuruar njerëzimit komoditet shpirtëror dhe kulturë materiale. Kjo periudhë e artë e civilizimit dhe kulturës greke, fatëkeqësisht ndërpritet me vdekjen e Aleksandrit të Maqedonisë, mbret i Maqedonisë dhe djali i Filipit II dhe Olipisë, njëri prej udhëheqësve më të mëdhenj botëror, nxënës i Aristotelit. Me ndihmën e tij ka ardhur deri te paraqitja dhe zgjerimi i kulturës helene në Lindje, e cila ka qenë përzierje e kulturës greke dhe asaj të Lindjes së Afërt. Pasi që Aleksandrin nuk ka pasur kush ta trashëgojë, udhëheqësit e tij (dijadosët) filluan luftën mes vete për pushtet. Në këtë luftë pësuan shumë shkencëtarë, ndërsa shumica kanë qenë të detyruar që ta lëshojnë Greqinë.

Personalitete

**ABDULATIF**

**BAGDADI**

**Abdulatif BAGDADI është lindur më 557 të vitit islamik. Njifet si personalitet i lartë dhe i sinqertë. Në fushën e shkencës përfitonte botën e ardhëshme. Sjelljen dhe mësimet a para i mori prej babait. Shkollimin e vazhdoi te dijetarët e Bagdadit. Si njëzetetë vjeçar mori rrugëtim për në Mosul, Damask, Kudus dhe Kairo.**

**Bagdadi zë vend të posaçëm në fushën e mjekësisë. Ishte teroticient dhe praktikant, profesor dhe mjek. Është ndër të parët që u mor me studimet e sëmundjes së sheqerit. Ka shkruar për simptomet dhe ka gjetur ilaçe. Vepra më e njohur në këtë fushë është "Mjekësia midis Kur'anit dhe Sunetit". Në këtë vepër përmbloodhi hadithet, që kishin të bëjnë me mjekësinë. Gjithashtu ka shkruar për barërat, ushqimin dhe mjekimin.**

**Bagdadi nuk ishte vetëm mjek me përvojë, por edhe njohës i mirë i botanikës. Ka ditur për barërat dhe karakteristikat e tyre mjekësore. Shumë shënime kanë mbetur në veprat e tij. Është marrur edhe me botën shtazore, këtë e vërtetojnë veprat e tij të kësaj lëmie.**

**Bagdadi ka pasur dëshirë për udhëtime. Në udhëtime është interesuar për rrethanat e jetesës dhe nivelin e popullatës. Vepra më e njohur në këtë fushë është "Dobitë dhe mësimet".**

**Ky shkencëtar islam la rreth 150 vepra, kurse më të njohurat janë "Komentimi i dyzet haditheve nga këndi i mjekësisë" dhe "Mrekullitë e botës shtazore".**

**Abdulatif BAGDADI vdiq gjatë udhëtimit për në haxh më 629 të vitit islamik në Bagdad.**